



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.10.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 9:42 dhe mbaroi në orën 10:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 29.10.2019 (Pika 1)***

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
11. *Përfaqësues të medias (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës. Ndërsa një gazetar prezent vetëm në pikën e parë, i cili largohet gjatë shqyrtimit të pikës së dytë.)*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}”.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Siç jeni vënë në dijeni, Këshilli do të vijojë me mbledhjen e datës 29 tetor 2019. Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sikurse jeni vënë në dijeni lidhur me rendin e ditës të mbledhjes së sotshme, Këshilli do marrë për shqyrtim dhe për vendimmarrje 5 çështje të rëndësishme.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për kthimin në funksionin e gjyqtarit.

Çështja e tretë ka të bëjë për shqyrtimin e kërkesës për kthimin në detyrë të gjyqtarit {...}.

Çështja e katërt ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme

Dhe çështja e fundit, jo më pak e rëndësishme, ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}.

Ky është rendi i ditës. Nëse nuk keni ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e rendit të ditës, atëherë vijojmë me shqyrtimin e çështjes së parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}, përpunuar kjo kërkesë/kjo vendimmarrje, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndërkohë që Këshilli vazhdon mbledhjen, kamerat i ftoj të dalin përjashta dhe gazetarët të ulen për të ndjekur vijimin e mbledhjes.

*(Kameramanët dalin nga salla e mbledhjes.)*

Atëherë, lidhur me relatimin e projekt-aktit, fjalën ia jap zonjës Marçela Shehu, për të relatuar.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa e datës 20.12.2018 e gjyqtarit {...} me objektin si më poshtë: Revokimin e vendimit nr.102, datë 28.10.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin është vendosur pezullimi i ushtrimit të detyrës së gjyqtarit {...} deri në përfundim të çështjes penale; Revokimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.98, datë 28.10.2016 me të cilin është vendosur shkarkimi nga funksioni drejtues i Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër z. {...}; Kthimin në vendin e mëparshëm të punës, për të përfunduar mandatin në funksionin drejtues, të ndërprerë në mënyrë të paligjshme.

Z. {...} deri në datën 27.10.2016, rezulton se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, njëkohësisht edhe funksionin e kryetarit të kësaj gjykate (i emëruar në këtë funksion me vendimin nr. 381, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë).

Më datë 27.10.2016, nga Emisioni Investigativ “Stop”, në Klan TV është transmetuar një material i cili ngrinte problematika në lidhje me veprime të ndryshme, të pretenduara si të kryera nga gjyqtari {...}.

Me datë 27.10.2016, kryesisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal me nr. 240 për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” parashikuar kjo nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Me shkresën nr. 7159 prot., datë 28.10.2016 Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar KLD-së shkarkimin nga pozicioni drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë të z. {...}.

Në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë është mbledhur në një mbledhje të jashtëzakonshme të datës 28.10.2016.

Në këtë mbledhje është përfshirë në rendin e ditës edhe kërkesa tjetër e Ministrisë së Drejtësisë për pezullimin e gjyqtarit nga detyra.

Me vendimin nr. 988 (*lapsus, pasi nr. i vendimit është 98*), datë 28.10.2016 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur shkarkimin nga funksioni drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z. {...}.

Me vendimin nr. 100, datë 28.10.2016 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë të inspektojnë bashkërisht veprimtarinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë z. {...} dhe të gjyqtares {...} për shkelje të rregullave të etikës.

Me vendimin nr. 102, datë 28.10.2016 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur të pezullojë gjyqtarin {...} nga ushtrimi i detyrës, pra nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Me vendimin nr. 6, datë 02.11.2016 Kryeinspektori i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka urdhëruar inspektimin e përbashkët të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve {...} dhe {...}, gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Në lidhje me procedimin penal të filluar ndaj gjyqtarit {...}, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, më datë 18.01.2017 ka vendosur që të deklarojë moskompetencën lëndore dhe kalimin e akteve pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Me vendimin e datës 25.05.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur pushimin e procedimit me argumentin se fakti nuk përbën veprë penale.

Kundër këtij vendimi të pushimit të procedimit penal është ushtruar ankim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1379, datë 25.07.2018 ka vendosur prishjen e vendimit datë 25.07.2018 “Për pushimin e procedimit penal nr. 149/2017” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme në lidhje me detyrat e caktuara.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 590, datë 27.09.2018 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.1379, datë 25.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duke rrëzuar ankimin e ankueses {...}”.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe dosja aktualisht ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

Nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë kryer veprimet e inspektimit. Referuar raportit të inspektimit, ky Inspektorat ka konstatuar se nuk provohen elementë të ushtrimit të detyrës së papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit, prandaj deri në zbardhjen e plotë nga organi procedues të audio regjistrimit, lidhur me autenticitetin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij, ka vlerësuar që të mbajë çështjen për verifikim në vijim.

Rezulton gjithashtu se gjyqtari {...}, i është drejtuar me padi edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 98, datë 28.10.2016 të KLD-së “Për shkarkimin nga detyra”; vendimin “Për pezullimin nga detyra e gjyqtarit”, konkretisht me të njëjtat kërkime me të cilat i është drejtuar edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e saj nr. 745, datë 01.03.2018 ka vendosur: Pranimin e pjeshëm të padisë; Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që t’i paguajë paditësit {...} pagën si gjyqtar, nga data 28.10.2016 e deri në marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me hetimin disiplinor të nisur ndaj tij, Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj. Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Vendimmarrja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin nga detyra e gjyqtarit dhe nga funksioni drejtues i kryetarit të gjykatës” është bërë bazuar në nenin

9877 (*lapsus, pasi është ligji*), datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Lidhur me kërkesën e paraqitur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vjen përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor me dy variante.

Në variantin e parë Komisioni ka konsideruar faktin që të njëjtat kërkitime që janë parashtruar përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë njëkohësisht në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Ashtu sikurse citova edhe në parashtrimin e fakteve, rezulton që Gjykata e Shkallës së Parë Administrative ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë e zotit {...}, duke rrëzuar kërkitimet e tjera, ndërkohë që çështja është ankimuar dhe aktualisht ndodhet për gjykim pra Gjykatës Administrative të Apelit.

Duke u bazuar në parashikimin procedural civil sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, një nga propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pikërisht pezullimi i shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga gjyqtari {...}, për rikthimin në funksionin e kryetarit dhe në detyrën e gjyqtarit për shkak të kërkesat janë në shqyrtim para Gjykatës Administrative të Apelit.

Varianti tjetër, nëse Këshilli do ta gjejë jo me vend variantin e parë të propozuar (i cili propozon pezullimin e shqyrtimit të këtyre kërkesave), varianti i dytë i propozuar ka lidhje me shqyrtimin në themel, duke propozuar që të dyja kërkesat e paraqitura nga gjyqtari {...} të rrëzohen.

Lidhur me kërkesën e tij për rikthimin në funksionin e kryetarit të gjykatës, duke kërkuar revokimin e vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që kjo kërkesë të rrëzohet si e pabazuar, duke konsideruar edhe faktin që tashmë ky Këshill nuk ka kompetenca për të marrë në shqyrtim ligjshmërinë e një organi tjetër.

Gjithashtu, Komisioni propozon edhe rrëzimin për revokimin e vendimit të pezullimit dhe rikthimin në detyrën e gjyqtarit, duke konsideruar faktin që me të vërtetë është vendosur pushimi i çështjes penale me vendim të formës së prerë, por kjo çështje aktualisht është në Gjykatën e Lartë (ndaj saj është ushtruar rekurs) dhe në eventualitetin që Gjykata e Lartë do të cenojë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të rikthejë çështjen për hetim, atëherë situata do të paraqitet ndryshe.

Bazuar në dispozitat e reja ligjore, të miratuara në korrik të 2019, Këshilli ka kompetencë bazuar në nenin 156 që të zgjasë kohëzgjatjen e këtij pezullimi, ndaj Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të rrëzojë të dyja kërkesat e paraqitura nga zoti {...}. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimet e Komisionit përcjellë përmes relatores?

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Shumë shkurt. Lidhur me propozimin e parë të Komisionit, si referencë ligjore do duhet të konsiderohet edhe neni 66 i Kodit të Procedurave Administrative që rregullon çështjet paraprake. Edhe në rastin konkret jemi përpara një çështjeje paraprake, për sa kohë rezulton që kërkimet që janë bërë në Këshill, ndërkohë janë bërë edhe përpara gjykatës dhe çështja tashmë ndodhet përpara Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas pikës 1 të kësaj dispozite: “1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e të cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”

Nga ana tjetër, sa i përket ankimit, referuar nenit 130 po të Kodit të Procedurave Administrative, do duhet të konsiderojmë që ndaj vendimit të pezullimit, pra sipas propozimit të parë, mund të bëhet ankim, bashkë me vendimin përfundimtar, për sa kohë ligji nuk ka parashikuar një ankim veçmas për një vendim pezullimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, ndonjë diskutim lidhur me dy propozimet e ardhura për çështjen konkrete apo do t'i hedhim direkt në votim propozimin e parë dhe propozimin e dytë?

Atëherë, kalojmë propozimin e parë.

Atëherë, Komisioni, kalojmë në votim propozimin e parë?

Pra, tek propozimi i parë, vendimmarrja e propozuar nga Komisioni është: Pezullimin e shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga gjyqtari {...}, për rikthimin e tij në

funksionin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në detyrën e gjyqtarit, për shkak se kërkesat janë për shqyrtim para Gjykatës Administrative të Apelit.

Kalojmë në votim?

Jeni dakord me këtë propozim?

*Maksim Qoku*: Pro.

*Brunilda Kadi*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Pezullimin e shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga gjyqtari {...}, për rikthimin e tij në funksionin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në detyrën e gjyqtarit për shkak se kërkesat janë për shqyrtim para Gjykatës Administrative të Apelit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, bashkë me vendimin përfundimtar. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.10.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mospranimin e kërkesës së z. {...} për kthimin në funksionin e gjyqtarit”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 9:42 dhe mbaroi në orën 10:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 29.10.2019 (Pika 2)***

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
11. *Përfaqësues i medias (i cili largohet gjatë shqyrtimit të pikës 2)*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mospranimin e kërkesës së z. {...} për kthimin në funksionin e gjyqtarit”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me kërkesën e zotit {...} për kthimin në funksionin e gjyqtarit. Këtë çështje do ta relatojë zoti Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Atëherë, në lidhje me kërkesën e zotit {...} për ekzekutimin e vendimit nr.2839, datë 25.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, fillimisht më lejoni të paraqes fakte, të cilat kanë shoqëruar këtë vendimmarrje.

Me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 8, datë 30.08.1996 zoti {...} emërohet ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Dekret të Presidentit të Republikës nr.2526, datë 14.02.2000, z. {...}, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. 81, datë 29.04.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndër të tjera është vendosur që z. {...}, i emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Shkodër, me Dekret nr.2526, datë 14.02.2000, i propozohet Presidentit të Republikës të korrigjojë emërimin duke e cilësuar gjyqtar ushtarak në atë gjykatë”.

Me Vendimin nr.230, datë 28.05.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndër të tjera është vendosur se: “...pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me shërbimin pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, të gjyqtarit të Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër, z. {...}, si edhe ruajtjes për këtë gjyqtar, të statusit të gjyqtarit, duke marrë parasysh edhe pëlqimin nga z. {...}, në përfundim vendosi ta pranojë këtë kërkesë... .”

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 21.05.2008 “Për Shkarkim dhe Emërim në detyrë”, z. {...} është emëruar në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Gjatë vijimit të ushtrimit të këtij funksioni, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 21.01.2009, “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”, ndër të tjera është vendosur: “1. Z. {...}, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë... .”

Me shkresën nr.2564/1, datë 16.05.2019 të Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave është dërguar relacioni që shoqëron vendimmarrjen e mësipërme, ku evidentohen shkeljet e konstatuara dhe që kanë përberë shkak për shkarkimin e z. {...} nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Konkretisht, në këtë relacion pasqyrohet se: “...Këto shkelje në mënyrë të përmbledhur janë; Zvarritje e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës nëpërmjet shkeljes së afateve ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të paraqitur nga subjektet e shpronësuara (gjithsej 155 raste); Organizim i dobët i punës brenda strukturës administrative të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nëpërmjet mungesës së mbikëqyrjes së zbatimit të afateve ligjore, marrjes së masave disiplinore për shkeljen e këtyre afateve ligjore, mosrespektimit të Kodit të Punës lidhur me shpërblimin e punonjësve për orët jashtë orarit, lëvizjes së shpeshtë e të pajustificuar të personelit dhe mungesës së mbikëqyrjes së zbatimit të detyrimeve ligjore nga zyra e

Arkiv-Protokollit për komunikimet/njoftimet si brenda Agjencisë dhe Zyrat rajonale, ashtu edhe me të tretë... .”

Krahas kësaj procedure disiplinore, mbi informacionin “për referimin e veprës penale” datë 22.09.2008 të oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo e fundit më datë 29.09.2008 ka regjistruar procedimin penal nr.4908, viti 2008 për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim”, parashikuar përkatësisht nga neni 248-25 i Kodit Penal. Në këtë procedim penal z. {...} fillimisht është regjistruar si autor i dyshuar i veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” në bashkëpunim parashikuar nga nenet 248-25 të Kodit Penal, ndërsa në datën 08.10.2008 ai është marrë në cilësinë e të pandehurit, duke u akuzuar për kryerjen e veprës penale të sipërpërmendur.

Në përfundim të hetimeve paraprake, më datë 24.04.2009, çështja penale kundër z. {...} është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr.718, 07.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tirane është vendosur “Deklarimi i pafajshëm i të pandehurit {...}”.

Me vendimin 1280, datë 13.02.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr.718, datë 07.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë”.

Me shkresën e datës 18.02.2013, z. {...} i është drejtuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku pasi informon se “...menjëherë pas lirimit nga detyra gjatë kohës që kryeja lejen e zakonshme më është komunikuar akuza duke me vendosur në pamundësi ligjore për t’u kthyer në funksionin e gjyqtarit”, duke kërkuar në përfundim kthimin në funksionin e gjyqtarit.

Nuk rezulton që ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë të ketë marrë në shqyrtim dhe të jetë shprehur për kërkesën e z. {...} për kthimin në detyrën e gjyqtarit.

Më datë 17.03.2015, z. {...} ka iniciuar një proces gjyqësor administrativ kundër ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kërkuar “Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur për të rikthyer në detyrën e gjykatësit, në respekt të statusit të paditësit si edhe detyrimin për të paguar pagën e gjykatësit nga data 21.02.2009 deri në fillimin e detyrës”. Tërheq vëmendjen që kjo datë është data me anë të së cilës, me Vendim të Këshillit të Ministrave është ndërprerë

komandimi ose emërimi si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Me vendimin nr.2839, datë 25.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse z. {...}, depozituar më datë 18.02.2013... .”

Me vendimin nr. 121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është vendosur “Lënien në fuqi të Vendimit nr.2839, datë 25.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Me vendimin nr.1057, datë 16.10.2018 të Gjykatës së Lartë është vendosur “Mospranimin e rekursit të palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kundër vendimit nr.121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit”.

Më pas, më datë 29.02.2016, z. {...} ka investuar Shoqërinë Përmbartimore private duke kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative si më lart, ndërsa nga përmbartuesi gjyqësor, përmes njoftimeve dhe kërkesave nr. 984, datë 29.02.2016, fillimisht ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe më pas, Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ka kërkuar ekzekutimin e vendimit nr.2839, datë 25.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në lidhje me ligjin e zbatueshëm, kemi paraqitur një sërë dispozitash, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe më pas ligjit organik, të cilët synojnë garantimin dhe zhvillimin e statusit të gjyqtarit si dhe mbarimin e tij. Kështu që, s’po ju humbas kohë për t’jua cituar dhe po kalojmë direkt tek vlerësimi.

Së pari, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor, përcaktuar edhe me vendim gjyqësor të formës së prerë, për të marrë në shqyrtim kërkesën e z. {...}, për kthimin në funksionin e gjyqtarit.

Ky detyrim buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, konkretisht nga vendimi nr.2839, datë 25.05.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së Paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse z. {...}, depozituar më datë 18.02.2013... .”.

Edhe në lidhje me arsyetimin në lidhje me këtë vlerësim që ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nuk po ju humbas kohë, pasi jurisprudenca jonë e Gjykatës Kushtetuese por njëkohësisht edhe Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka një praktikë dhe doktrinë tashmë të konsoliduar në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe e konsideron atë si element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe mendoj se nuk besoj se duhet të kemi debate në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi.

Kështu që, po kaloj tek pjesa më kryesore, e cila konsiston në dy opinionet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, të cilat të dyja të çojnë tek refuzimi i kësaj kërkesë për t'u kthyer si gjyqtar, por gjithsesi ka mendime paralele ndërmjet tyre.

Atëherë, arsyetimi i parë është:

Kushtetuta ka përcaktuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organi kushtetues përgjegjës për zhvillimin e karrierës së gjyqtareve (të shkallës së parë dhe apelit) dhe sa i përket përgjegjësisë disiplinore të tyre. Për të realizuar këto përgjegjësi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qenë i përbërë në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizonin lidhjen me korpusin gjyqësor, duke e mundur në këtë mënyrë pavarësinë e gjykatës dhe duke e mbrojtur atë nga ndërhyrjet e çdo pushteti tjetër. Në baze të neneve 18-27 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” përcaktohet se vullneti i këtij Institucioni realizohet nëpërmjet vendimmarrjes kolegjiale të arritur nga shumica e votave të anëtarëve të pranishëm. Një vullnet i tillë është shprehur edhe për dhënien e pëlqimit (vendimin nr.230, datë 28.05.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë) në bazë të të cilit, z.{...} i është dhënë leje për të shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa pas këtij lejimi, ai është emëruar dhe ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për një periudhë afërsisht 8 muaj (Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për Shkarkim dhe Emërim në detyrë”, nr. 627, datë 21.05.2008) z. {...} është emëruar në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009, “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”, ku ndër të tjera është vendosur: se z. {...}, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë.

Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët sanksionohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe moshja e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme.

Në fakt ligji nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” garanton në dispozitat e tij të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile. Në mënyrë shteruese në nenin 20 ky ligj ka përcaktuar rastet e përfundimit të statusit të gjyqtarit a) jep dorëheqjen; b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension; c) dënohet me vendim gjyqësorë të formës së prerë, ç) shkarkohet nga detyra.

Sistemi i garancive në lidhje me ruajtjen e vendit të punës dhe për rrjedhojë edhe te statusit është pasqyruar edhe ne rastet kur gjyqtari punonte në detyrën e jo gjyqtarit pranë një institucioni të drejtësisë.

Konkretisht në neni 28 të ligjit përcaktohet se: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës. 2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave....”.

Ndërsa në nenin 4, pika 6, të ligjit nr.8678, date 14.05.2001 përcaktohet se gjyqtarët dhe prokuroret që shërbejnë në strukturat e përmendura në piken 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, rriemërohen gjyqtar a prokuror pa konkurs.

Në rastin në shqyrtim, z. {...}, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009 “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”, i është zgjidhur kontrata e shërbimit pranë institucionit të drejtësisë në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zgjidhje kjo e kontratës së shërbimit që ka ndodhur përpara afatit trevjeçar të lejes së akorduar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pas këtij momenti, pra pas datës 21.01.2009, z. {...}, për të realizuar të drejtat e njohura nga ligji, ka pasur të drejtën t’i kërkonte ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë riemërimin në detyrën e gjyqtarit, për me tepër kur ndërprerja e shërbimit në institucionet e drejtësisë ka ndodhur pas afërsisht 9 muaj nga momenti i dhënies së pëlqimit nga ish-Këshilli i Lartë Gjyqësor (ish-KLD-ja). Dispozita e nenit 28 të ligjit të sipërcituar nuk përcakton në mënyre të shprehur, nëse gjyqtari “ipso jure” kthehet në vendin e mëparshëm me mbarimin e ushtrimit të funksionit të nëpunësit publik në institucionin e drejtësisë ku shërben, por ky fakt deduktohet nga analiza e paketës së sistemit të garancive për gjyqtarin. Kjo paketë në kuadër të garancisë ruante statusin e gjyqtarit ex legge për ato subjekte që, me pëlqimin individual dhe të ish-KLD-së, gjate gjithë periudhës trevjeçare ushtronin detyra ekzekutive në Ministrinë e Drejtësisë. Gjatë ushtrimit të detyrës ekzekutive funksioni i gjyqtarit dhe statusi i gjyqtarit ruhej për periudhën trevjeçare. Vazhdimi i detyrës pas kalimit të këtij afati pa pëlqimin e KLD-së shkaktonte humbjen e statusit të gjyqtarit.

Edhe në ligjin e ri “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, neni 57, përcaktohet se “Magjistrati me një pozicion të përhershëm, kur përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin, sipas parashikimeve të nenit 59 të këtij ligji, pas mbarimit të periudhës së përkohshme ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm të përhershëm”.

Dorëheqja e gjyqtarit nuk ka gjetur rregullim të detajuar në ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nuk përcakton procedurë dhe institutin e formës, të aktit të dorëheqjes. Për rrjedhim, në kushtet kur nuk kërkohet që forma e aktit të jetë shkresore, vullneti i kërkuesit deduktohet nga qëndrimi subjektiv i tij ndaj detyrimit kushtetues për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në vendin e punës ku ai është emëruar. Pavarësisht se kërkuesi nuk ka qenë pjesë e shërbimit civil të zakonshëm, ai ka qenë pjesë e shërbimit tipik publik. Një



gjqtar ka përgjegjësi specifike në fushën e administrimit të drejtësisë, një sferë në të cilën shtetet ushtrojnë pushtet sovran. Për pasojë, një gjyqtar merr pjesë direkt në ushtrimin e pushteteve të dhëna nga ligji publik dhe ka detyrime të parashikuara për të mbrojtur interesat e përgjithshme të shtetit, (atë të dhënies së drejtësisë), ku përfshihet edhe detyrimi për t'u kthyer në vendin e punës në momentin e zgjidhjes së kontratës nga ana e përfaqësuesve të institucionit të drejtësisë. Në kushtet kur z. {...} nuk ka përfunduar normalisht ushtrimin e detyrës si Drejtor i Përgjithshëm, për shkak të shkarkimit të tij me vendimin nr.54, datë 21.01.2009, të Këshillit të Ministrave, ai duhet të kishte kërkuar riintegrimin në funksionin e gjyqtarit, statusin e të cilin ai vazhdonte ta gëzonte. Por, z. {...}, me veprime konkludente përmes moskërkimit të kthimit në detyrën e gjyqtarit, ka shprehur vullnetin për te mos vijuar mbajtjen e statusit të gjyqtarit, duke nënkuptuar dorëheqjen e tij dhe njëkohësisht mbarimin e statusit, pasi, siç u arsyetua më lart, z. {...} vazhdonte të ruante statusin e gjyqtarit deri më datë 28.05.2011 dhe në kuadër të këtij statusi nuk kishte pengese ligjore për t'u rikthyer në këtë detyrë. Faktin e vazhdimësisë së detyrës dhe detyrimin e kthimit në punë për të përmbushur detyrimet që rrjedh nga kontrata e shërbimit në mënyrë indirekte e pranon edhe z. {...} kur, në objektin e padisë me anë të së cilës ai ka investuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, ai ka kërkuar “Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur për t'u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, në respekt të statusit të paditësit si edhe detyrimin për të paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.02.2009”, pra është datë që me vendim qeverie ai është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit të Pronave. Kjo datë i korrespondon periudhës një muaj pas shkarkimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nga detyra e drejtorit të agjencisë.

Në kushtet kur punëdhënësi, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk mund të vijonte ruajtjen e vendit të punës si gjyqtar për z. {...}, pasi veprimi konkludent i mos kërkimit të kthimit në detyrën e gjyqtarit pa shkak është interpretuar si dorëheqje e tij nga ku funksion dhe rrjedhimisht, si mbarim i statusit të gjyqtarit. Për rrjedhim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6265, datë 16.09.2009, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve, për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit” është vendosur ndër të tjera që në gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër, nga 19 gjyqtarë, të reduktohet numri i gjyqtarëve nga 21 në 19.

Mospërmbushja nga z. {...} e kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është tregues tjetër konkludent i pasojave që ai ka dëshiruar të krijojë për shkak të dorëheqjes. Sipas këtij ligji, të gjithë subjektet që gëzonin statusin e gjyqtarit, janë përcaktuar si subjekt rivlerësimi kalimtar dhe si të tillë ata kanë pasur detyrimin ligjor për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve përkatës të pasurisë, figurës dhe vetëvlerësimit profesional, me qëllim mundësimin e procedurës së rivlerësimit në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Pra një kërkesë e tillë dhe një dosje e tillë mungon në arkivën e KLD-së.

Arsyetimi i dytë:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009 “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”, ndër të tjera është vendosur së z. {...} Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë.

Nga aktet shkresore, përfshirë edhe ato të depozituar nga z. {...}, nuk rezulton që ky vendim, akt administrativ individual të jetë kundërshtuar gjyqësisht përpara gjykatave administrative.

Akti administrativ individual i mësipërm, si shfaqje e një vullneti pushteti nga organi që ushtron veprimtari administrative, në përputhje të plotë me kushtetutën dhe me ligjet, me qëllim krijimin, ndryshimin ose shuarjen e pasojave juridike të caktuara, vazhdon të jetë në fuqi ndërsa nëpërmjet tij rezulton të jetë zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontrata e shërbimit mes z. {...} dhe organit të administratës shtetërore. Shkarkimi nga detyra e gjyqtarit që, me kërkesë të institucionit të drejtësisë, me pëlqimin e tij, si dhe me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka shërbyer në një institucion të drejtësisë, përben shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit në kuptim të nenit 20, germa “ç”, të ligjit nr.9877, 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohej se gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve, pika ç), kur shkarkohet nga detyra. Kjo për shkak të fuqisë së pakontestuar dhe efekteve juridike të aktit administrativ individual të zgjidhjes së kontratës së shërbimit publik.

Referuar ligjit të kohës nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për gjyqtarin, që me kërkesën e institucioneve e me pëlqimin e tij, si dhe me vendim të KLD-së, gjatë periudhës së shërbimit në strukturat

e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si ndihmësligjor ose këshilltar i gjyqarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit apo si prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës, ky ligj nuk ka marrë përsipër rregullimin e përgjegjësive disiplinore. Por po ashtu, ky ligj nuk ka përjashtuar nga përgjegjësia disiplinore ata gjyqtar që, me pëlqimin e tyre, lejoheshin të shërbenin, për një periudhë deri në 3 vjet, në një institucion brenda sistemit të drejtësisë. Duke mos i përjashtuar nga përgjegjësia disiplinore, si dhe duke heshtur sa i përket rregullimit të kësaj përgjegjësie, mund të konkludohet se ligji i kohës ka pranuar përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve që, me pëlqimin e tyre, lejoheshin të shërbenin në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, përgjegjësi kjo e rregulluar rast pas rasti sipas ligjit organik të institucionit përkatës ku gjyqtari lejohej të shërbente, me pëlqimin e tij. Në këtë kuptim, çdo procedurë e vlefshme disiplinore e ndjekur sipas ligjit organik përkatës të atij institucioni brenda sistemit të drejtësisë ku gjyqtari është lejuar të shërbejë sipas kërkesave të nenit 28 të ligjit të lartpërmendur, në të cilën është urdhëruar marrja e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, përben në çdo rast një rrethanë që çon në mbarimin e statusit të gjyqarit. Ligji në fjalë i kohës, ndryshe nga ligji aktualisht në fuqi (96/2016), nuk ka parashikuar mundësinë dhe të drejtën e gjyqarit të lejuar, me pëlqimin e tij, për të shërbyer në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, për të kërkuar shqyrtimin e procedimit disiplinor nga organi qeverisës i këtij sistemi, pra nga ish-KLD-ja. Përkundrazi, duke heshtur, ligji i kohës ka konsideruar të vlefshëm çdo masë disiplinore të dhënë nga institucioni përkatës ndaj një gjyqtari të lejuar, me pëlqimin e tij, për të shërbyer në një institucion brenda sistemit të drejtësisë.

Vlen të theksohet se në ligjin aktual në fuqi që rregullon statusin e gjyqarit, pra në ligjin nr. 96/2016, ato çka në mënyrë të heshtur rezultojnë nga ligji i mëparshëm, që ka rregulluar statusin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, sa i përket përgjegjësisë disiplinore të gjyqarit që, me pëlqimin e tij, lejohej të shërbente në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, janë parashikuar tashmë shprehimisht në nenin 53.

Po ashtu, vlen të theksohet gjithashtu se sipas ligjit aktual në fuqi që rregullon statusin e gjyqarit, ligjit nr. 96/2016, pasja e një mase disiplinore “largim nga detyra”, përbën kriter ndalues për rekrutimin e gjyqarit (neni 28) apo për mbarimin e statusit të magjistratit në rast të vërtetimit të një rrethane të tillë (neni 64/b dhe neni 66).

Sa më sipër, për sa kohë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009 “Për shkarkim dhe emërim në detyrë” është në fuqi dhe i pakontestuar gjyqësisht nga z. {...}, një rrethanë e tillë pengon rikthimin në detyrën e gjyqtarit të z.{...}, përderisa për shkak të kësaj rrethane statusi i gjyqtarit për të ka mbaruar dhe ai nuk mund të gëzojë të drejtat që rrjedhin nga ky status.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro për relatimin shumë ezaurues të çështjes. Atëherë, ftoj kolegët për diskutim, nëse kanë, përpara se ta hedhim në votim projekt-propozimin e bërë nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Faleminderit!

Falënderoj relatorin për parashtrimin dhe do desha që, për orientim, unë do referoj muaj dhe vite, ndërkohë datat janë të sakta me relacionin.

Mendoj njëherë që i gjithë terreni që ne duhet të shprehemi është legjislacioni i mëparshëm dhe duhet të bëjmë kujdes kur në një situatë kur nga momenti që gjyqtari ose magjistrati i ka kërkuar ish-organit të mëparshëm të kthehet në detyrë, ne nuk mund të pretendojmë që kishte legjislacion të mëpasshëm, aq më tepër që ky i riu, që në fakt është i ndryshëm në thelb nga rregullimet që bënte legjislacioni i mëparshëm.

Në analizën e fakteve që kam bërë për gjyqtarin në fjalë, rezulton që pas dhënies së pëlqimit dhe marrjes së lejes për pezullimin e statusit nga ish-organi (KLD-ja), ka marrë emërimin në një detyrë publike.

Emërimin e ka marrë në maj të vitit 2008 dhe ndërkohë është shkarkuar në janar (por shkresa është e shkurtit) 2009. Ndërkohë, në shtator të 2008 ka nisur një procedim penal. Nga analiza e kujdesshme, -them unë, që i kam bërë dosjes, unë nuk kam parë që në bazë të nenit, më duket është neni 20 e... -më falni pak, -të ligjit “Për pushtetin...”, nuk është kërkuar autorizimi nga ana e organit kompetent (29-ta), KLD-ja, për procedimin penal ndaj magjistratit. Sepse këtu duhet parë edhe një kleçkë në lidhje me faktin e procedimit penal, që në arsyetimin e parë nuk përmendet.

Duke qenë që neni 29 shprehet për përgjegjësinë penale të gjyqtarit, në pikën 3 të këtij neni, citoj: “Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë”. Sepse në bazë të nenit 4, në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme për të marrë pagën.

Pra flasim që në kohëvazhdimin e detyrës, pra pas emërimit dhe para shkarkimit është marrë i pandehur në muajin tetor dhe ka nisur procedimi penal dhe mua, nuk më rezulton ky lloj vendimi që të dalim tek vendimi tjetër.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

Jo! Ka një rëndësi sepse tek neni 23, që thamë, neni 20, tek palëvizshmëria, ne duhet të marrim në konsideratë dy pikat, jo pikën /ç/ “shkarkohet nga detyra” sepse kam idenë që pika /ç/ i referohet faktit kur ai është gjyqtar. Pra shkarkimi nga detyra në situatën e të qenit gjyqtar. Ne në fakt kemi një situatë komplet tjetër dhe kjo situatë mund të cenohet nga pika /c/ e po këtij neni që thotë: “c) Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Pra gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra përveçse kur dhe kjo situatë e gjendjes penale e ka mbajtur në atë pamundësinë për të kërkuar kthimin tek vendi i mëparshëm i punës, pra që thuhet nuk rezulton.

Tani, le t'i kthehemi situatës në aspektin administrativ. Masa e shkarkimit ne e dimë që është shumë e thjeshtë. Domethënë është shkarkim dhe emërim. Shkarkohet filani. Emërohet filani. Ky vendim shkarkimi është bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, si organ nën varësie që ka qenë në atë kohë, organi ku punonte gjyqtari dhe ky urdher ka caktuar grupin e punës dhe ka lënë detyrat. Në fakt, urdhri nuk gjendej në dosje, por gjithsesi në aspektin e kontrollit dyjavor që përmbahet në dosje, kanë dalë edhe ato rezultate.

Tani, në gjykimin tim unë them që gjyqtari mund të jetë shumë i aftë të bëjë gjyqtarin por nuk di të bëjë punëtorin administrativ. Në analizë të raportit që kam bërë, kam parë që të gjitha kushtet janë të një natyre administrative. Pra ‘mosorganizim i mirë’, ‘zvarritje’, ‘mospagesa e kësaj’, etj., etj.

Problemi është që ai është një funksionar i emëruar dhe si funksionar i emëruar, i tillë është shkarkuar, por rregullimi i pozitës juridike është bërë nga Kodi i Punës. Kjo do të thotë që, duke qenë që është pushuar, shkarkuar, natyra e kësaj mase disiplinore nuk mund të mbetet apriori në konsideratë si një shkelje e mirëfilltë disiplinore, por duhej patjetër që të merrej në shqyrtim nga ish-organi i atëhershëm KLD-ja.

Tek ndoqa referimin e zotit Toro, mua më ngjit shumë jo vetëm koherenca e veprimeve që ka bërë magjistrati, por edhe referime në bazën ligjore që ka bërë relatori dhe, tek i referohem Kartës Evropiane, me të gjitha ato çka janë referuar në relacion, neve

na del që duhet të bëjmë shumë kujdes sepse po “gjykojmë” (në thonjëza) një gjyqtar në pozicionin kur nuk ka qenë gjyqtar dhe ai afati 3-vjeçar që ka pezulluar statusin, ka një rëndësi për gjyqtarin sepse garanton gjyqtarin në disa të drejta që nuk mund t’i cenohen, por që edhe duhet t’i kontrollohen në rast se një masë disiplinore e merr gjatë periudhës kur është në shërbim, pra në ushtrimin e detyrës si gjyqtar. Dhe ne fakt këtu jemi. Ne duhet ta harrojmë legjislacionin e ri. Duhet, në fakt, të korrigjojmë një gabim të atij organi që, mbasi ka përmbyllur të gjithë procedurën ligjore, gjyqtari ka bërë kërkesën përpara hyrjes në fuqi të paketës ligjore dhe të konstituimit të organit tonë dhe këtë KLD-ja nuk e ka bërë kurrë.

Nëse do themi të referojmë në lidhje me argumentin e parë që është parashkruar e drejta për sa nuk kërkoi dhe nënkupton që nuk e deshe, Gjykata Administrative e ka zgjidhur këtë fakt. Ka thënë që nuk parashkruhet dhe organi duhej të shprehej. Pra ne jemi në situatën që organi nuk është shprehur. Nuk është shprehur për një situatë që është marrë një shkarkim në një pozicion tjetër, ndërkohë që ka pasur pezullim statusin.

Kështu që, fakti është i tillë, që unë mendoj që kjo nuk është një masë e mirëfilltë disiplinore. Në analizën nëse ishte apo s’ishte, -duhej të shprehej organi. Kështu që, ne na duhet vetëm të referojmë në atë çka ka dhënë motivacioni dhe unë i shoh ato shkaqe normale. E kundërta do të ishte nëse do të ishin shkelje e etikës së rëndë. Unë mbetem i idesë që për shkelje etike në çdo kohë, nuk mund të justifikohet që një person të punojë gjyqtar. Prandaj dhe them që në aspektin që po referojmë, ne duhet të marrim në konsideratë, jo vetëm nenin 20 tek pika /ç/, por pikën /c/ kur gjyqtari ishte në procedim penal. Dhe çka ndodhur? Në momentin që ka marrë pafajësinë, në të dyja shkallët që ka marrë vendimi formë të prerë, brenda 5 ditëve ka bërë kërkesën për t’u emëruar në vendin e punës sepse e ka pasur pengesë këtë pikë në bazë të ligjit dhe vetëm pafajësia e justifikonte. E gjithë procedura tjetër pastaj është thjesht një stendbaj (*standby*). Ai bëj kërkesë, –mos u shpreh; bëj kërkesë, -mos u shpreh; dhe jemi në situatën e tillë. Pra ne do të na duhet që në referencë të legjislacionit të mëparshëm, të shprehim atë që në fakt duhet ta bënte organi i mëparshëm, në lidhje me masën dhe sa ajo ndikon tek statusi, por kurrë, në asnjë rast nuk mund të pranojmë që gjykatësi e ka humbur statusin, qoftë edhe si pasojë e mosveprimit, qoftë edhe si pasojë aq më tepër të pasjes së një mase në fuqi, që këtë s’duhet ta marrim fare në konsideratë sepse nuk mundet që pikën /dh/ të nenit 28 ta

referojmë për situatën në fjalë, kur gjendja ka ngelur e pezulluar që nga momenti i fundit (më duket 2015-ta, 2016-ta), që ka futur kërkesën përpara organit kompetent. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Atëherë, thjesht për sqarim.

Akti administrativ këtu është Vendimi i Këshillit të Ministrave 54, 21.01.2009 i cili ka pasur prelud një procedim administrativ të mëparshëm, i shprehur dhe i konkretizuar/materializuar nëpërmjet një relacioni ku kanë konstatuar disa shkelje. Në kuadër të masës disiplinore, masa e shkarkimit është masa më e rëndë për një nëpunës të shërbimit civil, po ashtu edhe për gjyqtarin, kur i referohesh ligjit “Për statusin e gjyqtarit”. Asnjë organ administrativ nuk mund të marrë në shqyrtim dot ligjshmërinë e këtij akti, përfshirë këtu edhe KLD-në, nuk mund t’i hynte dot ligjshmërisë së Vendimit të Këshillit të Ministrave. Do të duhet ta merrte vetë subjekti iniciativën për ta goditur këtë akt dhe për të anulizuar efektet që ai ka krijuar.

Të kalojmë tek pjesa, meqenëse u përmend autorizimi për fillimin e procedimit penal, kur fillohet ndaj një gjyqtari, kërkohet autorizimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nëse do të shikoni dosjen penale. Nuk ka asnjë kërkesë ku subjekti, pra i pandehuri (ose në rastin konkret është shpallur i pafajshëm) të ketë kërkuar pavlefshmërinë e akteve të prokurorisë në lidhje me mungesën e autorizimit për fillimin sepse me cilësinë e gjyqtarit, pra ai ka qenë gjyqtar, unë kam qenë gjyqtar, në momentin që dikush ka filluar procedimin penal në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë statusin e gjyqtarit, automatikisht kjo është e pavlefshme. Një kërkim i tillë nuk është bërë. Pra vetë subjekti ka pranuar faktin që ai nuk ka qenë gjyqtar në kohën kur ushtronte detyrën e drejtorit të përgjithshëm.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Ndonjë diskutim tjetër?

Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Në fakt, dy pika kryesore që do diskutoja, u ezauruan nga kolegu Toro, pikërisht këto të dyja.

Por thjesht një pyetje për kolegun Qoku. Juve morët përsipër të analizoni arsyen e masës disiplinore që është marrë në atë kohë. Thjesht një pyetje. Ju mendoni që Këshilli

mund t'i hyjë kësaj, e ka këtë kompetencë që t'i hyjë? Dhe e dyta, thjesht po ripërsëris atë që tha zoti Toro dhe po theksoj, -mund ta injorojmë ne një Vendim të Këshillit të Ministrave që është sot në fuqi? Sepse ai nuk është kundërshtuar, nuk është kontestuar me asnjë vendim gjykatë. Mundemi ne si Këshill ta injorojmë dhe t'i hyjmë pastaj themelit ose arsyeve ishin apo s'ishin, kishin lidhje a s'kishin lidhje me gjyqtarin?

**Maksim Qoku:** E para njëherë, unë prandaj thashë që duhet të bëjmë kujdesin midis aplikimit të ligjit të kohës kur konflikti ka lindur dhe e dyta...

**Brunilda Kadi:** Maksi, me atë ligj po flasim të gjithë. Thjesht, ju si e vlerësoni? Se po thoni të kemi kujdes, por çfarë propozoni? Si e mendoni? Që ta diskutojmë edhe mbase bashkohemi me mendimin tuaj. Çfarë propozoni? Se kujdes besoj të gjithë e kemi, se e kemi detyrim ligjor atë.

**Maksim Qoku:** Përpara se të dalim se çfarë propozoj, ideja është të kuptohemi.

Unë them që neni 20 i cili referon tek shkaqet e lëvizshmërisë, pikërisht këtu e ka idenë, që flitet për shkarkimin e gjyqtarit në detyrë. Ndërkohë që ai gjyqtar nuk ishte në detyrë. Problemi është që, procedimi penal kur nis, e detyron organin e akuzës të kërkojë autorizimin nga organi. Dhe pse referova tek Karta Evropiane? -që e kam përpara. Thotë, ka një statut për gjyqtarët, që është një status për të drejtat që garantojnë këto të fundit, dhe thotë: "Statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv-legjislativ", pra është organi që garanton. Në situatën që po flasim, duke qenë që nisi një procedim penal i cili e pamundësonte këtë të fundit që të bënte kërkesën për kthim në vendin e punës, për efektin e vazhdimin të këtij procedimi, magjistrati (gjyqtari në fjalë) kaloi kohën e procedimit.

**Brunilda Kadi:** Ka ca rregulla procedurale Maksi. Në qoftë se s'e ka kërkuar vetë këtë (se ishte edhe gjyqtar), kam përshtypjen që ka ca institute të tjera siç është dekadencia për shembull.

**Maksim Qoku:** E ka zgjidhur Gjykata Administrative problemi e dekadencës.

**Brunilda Kadi:** Po flas për procedimin penal.

Ju thoni që i gjithë procedimi ka qenë i pavlefshëm se nuk është marrë autorizimi.

**Maksim Qoku:** Nuk them atë.



**Brunilda Kadi:** Tani, ai vetë si subjekt nuk e ka kërkuar. Kush je ti që thua që ai duhet ta kishte kërkuar, por s'e kërkoj dhe meqë s'e kërkoj... Të gjithë këtë domethënë. Ka ca rregulla procedurale.

**Maksim Qoku:** Të lutem. Referova nenin 29, dhe thashë tek pika 3: "Në rastin kur ndaj gjyqtarit jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, pezullohet nga detyra". Pra gjyqtari mund të ndiqet penalisht, por për këtë kërkohet autorizimi për fillimin e procedimit, me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këtë thotë neni 29, pika 1.

**Brunilda Kadi:** Është e drejtë ajo. Ka hequr dorë ai. Është e drejtë. Nuk e kërkoj. T'i do t'ia kërkosh të drejtën?

**Maksim Qoku:** Nuk e kam fjalën këtu.

Po them që kjo procedurë...

**Brunilda Kadi:** Ka pranuar ai të hetohet pa autorizim. Hoqi dorë ai.

**Maksim Qoku:** Pikërisht këtë po them. Ka pranuar të hetohet. Ka marrë pafajësinë. Mori formë të prerë pafajësia. Brenda 5 ditëve bëri kërkesën.

**Brunilda Kadi:** Çfarë pasoje ka kjo që s'është dhënë autorizimi? Sot, çfarë pasoje ka? Çfarë pasoje ka që nuk është dhënë autorizimi?

**Maksim Qoku:** Nuk e kam fare aty. Unë e kam tek fjala që gjykatësi, në kohën që bëri kërkimin, mbasi mori çështja penale formë të prerë, është në rregull me procedurën. Këtë po them. Organi i kohës i cili duhej të shprehej, nuk është shprehur. Dhe fakti që ne jemi sot këtu për një gjë që nuk është shprehur organi i mëparshëm, nëse detyrimet e atij organi bien mbi ne, atëherë ne jemi organ kushtetues dhe kemi autoritetin për t'u shprehur. Këtë po them. Pra, domethënë nuk mund të them që nuk e kemi. Kjo është ideja. Nëse a mundet ne ta injorojmë?! Ne mund ta shqyrtojmë, të marrim në konsideratë, pastaj të gjithë të tjerat që parashtrova..

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

Vendimi i shkarkimit. Nuk është Vendimi i Këshillit të Ministrave... është me efekte...

**Brunilda Kadi:** Pra ju mendoni që ne si Këshill mund ta shqyrtojmë në themel ka qenë apo s'ka qenë i drejtë ai vendimi i shkarkimit. Këtë po thoni?

*(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brikena Ukperaj:** S'e ka shkarkuar si gjyqtar.

**Brunilda Kadi:** Po mirë pra, Brikena, sido që ta ketë shqyrtuar, unë po pyes, -a mendoni që ne kemi kompetencë t'i hyjmë bazueshmërisë në prova dhe ligj të Vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin? Këtë pyetje i drejtova zotit Qoku!

**Maksim Qoku:** Nuk po i hyjmë atij vendimi pra, këtë po them.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, e injorojmë dot që ekziston? E injorojmë dot?

**Maksim Qoku:** Shkarkimi, që është pika /ç/, ka të bëjë për gjyqtarin në detyrë.

**Brunilda Kadi:** Maksi, e injorojmë dot, që ekziston, atë si vendim? Sepse ka një vendim të një organi që është Kryeministri, Këshilli i Ministrave që e ka shkarkuar për ato arsye që thuhet. Ne e injorojmë dot këtë vendimin?

**Maksim Qoku:** Nuk po shprehem e injorojmë apo nuk e injorojmë. Po të them që, fakti që pika e ligjit flet për shkarkim në detyrë, i referohet të qenit në detyrën gjyqtar. Sepse efekti i pezullimit 3-vjeçar atë e ka bërë që të pushohet nga një detyrë administrative, publike, por që duhesh marrë në konsideratë për efektin e qenies gjyqtar, gjë që ligji i sotshëm e thotë, që nëse një gjyqtar i komanduar nis një procedurë disiplinore, ajo mundet që të zgjidhet nga i komanduari, ose të bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose nga institucioni.

**Brunilda Kadi:** Nuk është i zbatueshëm në rastin konkret.

**Maksim Qoku:** Po pra, pikërisht pra. Nuk jemi në këtë situatë. Po them, fakti që s'ka pasur një rregullim të tillë ligjor...

**Brunilda Kadi:** Atëherë, gjyqtari në atë kohë mund t'i kishte kërkuar Këshillit të riktheheshe në detyrë dhe në qoftë se do vazhdonte procedimi penal, ai riktheheshe në detyrë dhe pezulloheshe për shkak të procedimit penal. Ky ishte ligji i kohës Maksi, meqë e ke me merak ligjin e kohës së mëparshëm.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, dëgjova diskutimin e zotit Qoku. Nga sa kuptova unë, nëse s'jam gabim, u tha që procesi penal i filluar ndaj zotit {...} e ka penguar atë të paraqesë ankim administrativ. Në fakt, nuk ka, referuar legjislacionit të kohës, asnjë pengesë që zoti {...} të ankimonte vendimin, aktin administrativ të shkarkimit nga detyra, qoftë edhe procesi penal nuk interferon dhe ta pengojë atë ligjërisht. Nëse në subkoshiencën e tij ka konsideruar që të mbarojë njëherë procesin penal dhe pastaj të shohë dhe aktin administrativ, kjo është një çështje tjetër, por nuk është e rëndësishme për ligjin.

Sa i përket argumentit që shkeljet që janë referuar për shkarkim nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk janë të atilla dhe ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë do duhet të shqyrtonte këto shkelje, nuk mendoj se i takon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vlerësojë natyrën e shkeljes dhe shkallën e tyre. Ato janë shkelje që ka konsideruar organi përkatës për shkarkimin nga detyra, ndërkohë që Këshilli nuk ka pasur, sipas ligjit të kohës (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë), asnjë hapësirë që të mund të shqyrtonte vendimmarrjet e organeve të tjera. Edhe sot, Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk ka hapësirë të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimmarrjeve të tjera. Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar vetëm një organ që mund të shqyrtojë ligjshmërinë e tyre, që është gjykata.

U përsërit disa herë nga zoti Qoku që ne duhet të konsiderojmë dispozitat e ligjit të vjetër dhe jo të ligjit të ri. Në fakt, dispozitat e ligjit të vjetër duhet t'i konsiderojmë për aq sa faktet referojnë në ligjin e vjetër, por ne nuk mund të shmangim as dispozitat e ligjit të ri. Nuk mund të themi apo të mbyllim sytë dhe të themi që gjyqtari, zoti {...} do kthehet në detyrën e gjyqtarit, pavarësisht se sot kemi një nga kriteret e zgjedhshmërisë, që është i vërtetuar. Pra zoti {...} është i shkarkuar nga detyra. Kjo paracaktohet në nenin 28 të ligjit dhe do duhet të verifikohet gjatë gjithë kohës nga KLGJ sipas ligjit të Statusit, për efekt të mbarimit të këtij statusi. Nëse konstatojmë, statusi i zotit {...} ka mbaruar që në momentin kur është shkarkuar nga detyra. Ish-Këshilli i Lartë nuk ka konsideruar, se as ligji ia obligonte, të merrte ndonjë vendim tjetër. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Po, faleminderit!

Në fakt unë, edhe kur kam parë aktet/materialet e mbledhjes, edhe kur kam lexuar relacionin, pikëpyetja ka qenë që, dakord kërkesa e zotit {...} duhet të rrëzohet, por kur i ka mbaruar statusi këtij gjyqtari? Sepse në të dy variantet, në variantin kur të pranojmë që me shkarkimin e tij nga organi administrativ ose nga Kryeministri i cili kishte edhe autoritetin për të bërë shkarkimin, automatikisht i ka mbaruar statusi, do të thotë që, që në janar të 2009-ës, këtij gjyqtari i ka mbaruar statusi. Nga ana tjetër, në qoftë se do të pranojmë që ky gjyqtar, me veprimet e tij dhe me vullnetin e tij, qoftë në momentin kur është shkarkuar, në momentin pastaj gjatë procedimit penal, qëndrimin e tij në procedimin penal, mënyrën se si ka investuar Këshillin, faktin që nuk ka dorëzuar

dokumentacionin e verifikimit, me sjelljen e tij ka treguar që ai, edhe vetë e ka vlerësuar që statusi i ka humbur, duhet të vendosim një moment, pra se kur i ka humbur statusi i gjyqtarit. Sepse vendimi i Këshillit do jetë deklarativ.

Në qoftë se ne do themi sot që gjyqtarit i rrëzojmë kërkesën për t'u rikthyer në sistem, do të pranojmë që këtij gjyqtari i ka mbaruar statusi.

Tani do të them qëndrimin tim. Lidhur me njërin nga variantet, ishte që gjyqtarit i mbaron statusi me shkarkimin e tij nga funksionet e administrative, për shkak se nuk i ka ankimuar dhe automatikisht në kushtet kur ligji nuk parashikonte në atë moment se si zhvillohej procedimi disiplinor, automatikisht vetë institucioni ku gjyqtari ishte i komanduar të kryente funksione administrative, kishte të drejtë ta shkarkonte jo vetëm nga funksioni por edhe nga detyra e gjyqtarit. Unë këtë qëndrim nuk e përkrah, për arsye se të pranojmë që statusi i gjyqtarit i ka humbur për shkak të shkarkimit nga institucioni ku ai ishte komanduar, do të thotë që të pranojmë që në Kushtetutë gjyqtari nuk u shkarkuaka nga organi por u shkarkuaka nga një organ tjetër administrativ.

Referojmë vendimin 78 të Gjykatës Kushtetuese (ndoshta i vitit 2017). Analizohet në mënyrë të detajuar instituti i komandimit të gjyqtarit, nën këndvështrimin edhe të ligjit të mëparshëm dhe të ligjit të ri. Gjykata Kushtetuese shprehet që gjyqtari, gjatë periudhës së komandimit, duhet të gëzojë të njëjtat garanci, që janë elementë të rëndësishëm të statusit të tij, sikundër dhe një gjyqtar në funksion. Gjyqtari në periudhën e komandimit, siç është zoti {...}, pra ka qenë gjatë një periudhe komandimi, me vendim të organit kompetent, ka gëzuar të gjitha të drejtat dhe garancitë që i njej statusi i gjyqtarit, për sa i përket procedimit disiplinor. Organi administrativ ka vlerësuar që ky gjyqtar, për funksionet administrative, duhet të shkarkohet. Por nuk ka thënë që ky gjyqtar duhet të shkarkohet edhe nga detyra e gjyqtarit sepse nuk mund të pranojmë.

Në këtë moment unë mendoj që, shkarkimi i gjyqtarit duhet të vinte përmes një procedimi disiplinor që vetë organi i tij duhet ta iniciojë. Çfarë ndodh sot? – për të parë atë që nuk ka qenë dje. Sot gjyqtari, në qoftë se komandohet në një institucion dhe është shkak për fillimin e procedimit disiplinor, ai njoftohet nga vetë institucioni dhe është zgjedhje e gjyqtarit nëse këtë procedim do ta referojë në Këshill ose do ta referojë në institucion. Është Këshilli ai që vazhdon pastaj për procedimin disiplinor, ku vetë institucioni vepron si ILD-ja, ndërkohë që nëse gjyqtari nuk e bën këtë zgjedhje,

institucioni vazhdon procedurën disiplinore dhe vendimi i institucionit gjithsesi pezullohet deri në momentin kur në qoftë se gjyqtari bën ankim në gjykatë. Pra nuk jam e mendimit që statusi i gjyqtarit i ka mbaruar për shkak sepse është shkarkuar nga funksionet administrative.

Më pas, jam dakord me variantin tjetër që propozon relatori që, mosveprimi i gjyqtarit (do ta argumentoj) për të kërkuar të drejtat që i burojnë nga statusi për një periudhë më shumë se 3 vjet, ku ai duhet të ishte i komanduar dhe nuk duhet të ushtronte detyrën e gjyqtarit, e penalizon me mbarimin e statusit sepse Këshilli nuk e ka patur detyrë që kryesisht të vendoste pezullimin e gjyqtarit. Këshilli ka patur një vendimmarrje për sa i përket periudhës së komandimit. Ky komandim është ndërprerë. Gjyqtari, me ndërprerjen e komandimit duhet të vinte dhe të kërkonte në Këshill rikthimin e tij si gjyqtar. Automatikisht, procedimi penal, sepse ai mund të mos e kishte marrë ende pozitën e të pandehurit ose mund të ishte person nën hetim, procedimi penal do të vijonte nga momenti kur as prokuroria nuk e ka kërkuar autorizimin apo pezullimin, Këshilli kryesisht nuk mund ta vendoste. Pra vetë gjyqtari duhet të vinte dhe të kërkonte në Këshill rikthimin e tij në vendin e punës. Fakti që nuk e ka kërkuar për më shumë se 3 vjet, kur ishte periudha maksimale që nuk mund të kryente detyrën e gjyqtarit, sjellja e mëvonshme e gjyqtarit, pavarësisht se mbas vitit 2015 ai ka kërkuar në Këshill dhe për të gjitha të tjerat që tha relatori, mendoj që për shkak të mosveprimeve të tij me anë të të cilave ka shfaqur edhe qëndrimin e tij nga vetë statutet që ka patur, e ka humbur statusin e gjyqtarit.

**Naureda Llagami:** Ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, për ta kuptuar më saktë propozimin e zonjës Ukperaj, ju keni ndonjë propozim konkret për të kaluar në votim apo të vazhdojmë me...

**Brikena Ukperaj:** Një nga variantet, variantin e parë që ka bërë relatori.

**Naureda Llagami:** Është e shprehur në vendimmarrje kjo?

Është arsyetimi!

Atëherë, shprehemi, kalojmë në votim nëse Këshilli është dakord mbi refuzimin e zotit {...} për kthimin në funksion të gjyqtarit dhe më pas diskutojmë arsyetimin. Kalojmë në votim lidhur me arsyetimin për këtë.

**Maksim Qoku:** Kundër.

*Brunilda Kadi*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Kundër.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Kundër.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Kundër.

*Naureda Llagami*: Pro.

Atëherë, keni nevojë të shprehemi për mënyrën e arsyetimit të..?

Le të jenë të dy paralel.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

Dakord. Nuk është çështje për vendimmarrje.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.10.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 9:42 dhe mbaroi në orën 10:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Klodian Rado, EUR{...}S.*
10. *Gregor Borkowski, EUR{...}S.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të gjyqtarit {...}”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila edhe kjo çështje ka të bëjë me një projektvendim për shqyrtimin e kërkesës, edhe kjo për rikthimin në detyrë, të gjyqtarit {...}. Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti ia jap fjalën relatores, zonjës Marçela Shehu.

*Maksim Qoku:* Faleminderit!

Për të mos dashur që të konsumoj relatoren sepse mbase do dilni me një mendim më të unifikuar, do desha që përpara se të relatohej çështja dhe të nisnim debatet, të bënim një dëgjese me kandidatin në fjalë, me zotin {...}, pra të thirrej përpara Këshillit, ku në tërësinë e të gjithë dosjes që kemi shqyrtuar, në ca pikëpyetje në gjëra që duhet t'i sqarojmë, do i kërkoja Këshillit që të caktonim një dëgjese me kandidatin në fjalë. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Do e hedhim në votim kërkesën e zotit Qoku lidhur me, që ta ftojme kandidatin për ta dëgjuar.



*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Kundër.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Kundër.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Kundër.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Kundër.

(7 vota pro, 4 vota kundër.)

Atëherë, e shtyjme këtë çështje për të pritur...

Atëherë, meqë shumica vendosi që zotin {...} ta thërrasim për një dëgjesë, çështjen nuk po e kalojmë për shqyrtim, tërhiqet për shqyrtim, për ta lënë në një seancë tjetër, duke ftuar zotin {...} në ambientet e Këshillit për ta dëgjuar.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 29.10.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 9:42 dhe mbaroi në orën 10:56.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti, fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Atëherë, po ju parashtroj relacionin për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër. Deri më datë 28 tetor 2019, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë për trajtim, ndër të tjera, edhe dy kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta të paraqitura nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër. Janë dy çështje në lëndë penale, objekt i të cilave është “Pushim i çështjes” dhe numri i gjyqtarëve që kërkohet është 2 në një rast dhe 1 në një rast. Gjykata e Apelit Shkodër, me shkresat përkatëse të dërguara pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka parashtruar si më poshtë:

Me shkresën e datës 14 tetor 2019, që është formulari i tipit miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, zëvendëskryetari i gjykatës ka kërkuar që Këshilli të caktojë dy gjyqtarë për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale paraqitur para kësaj gjykate më datë 04 shtator 2019. Nga përmbajtja e kërkesës, zëvendëskryetari shprehet se: “Kanë pengesë ligjore gjyqtare {...}, e cila ka paraqitur dorëheqje, miratuar me vendimin nr. 51 regj., datë 17.09.2019 të Zv/Kryetarit {...}. Në të njëjta kushte janë edhe gjyqtarët {...} e {...}. Po kështu edhe gjyqtari {...} e {...} janë në të njëjtat kushte papajtueshmërie. Gjyqtaret {...} dhe {...} nuk kanë pengesë në këtë çështje, por vazhdojnë të jenë me raporte mjekësore dhe duke qenë çështje e ngutshme lind nevoja për plotësim të trupit gjykues me dy anëtarë”.

Ndërkohë, me shkresën tjetër të datës 23 tetor 2019, zëvendëskryetari i ka kërkuar Këshillit të caktojë një gjyqtar për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale që është regjistruar pranë kësaj gjykate më datë 30 gusht 2019. Nga përmbajtja e kërkesës zëvendëskryetari shprehet se: “Kanë pengesë ligjore gjyqtare {...}, e cila ka paraqitur dorëheqje, miratuar me vendimin nr. 46 regj., datë 11.09.2019 të Zv/Kryetarit {...}. Në të njëjta kushte janë edhe gjyqtarët {...} e {...}. Po kështu kanë pengesë ligjore gjyqtarët {...} dhe {...}, të cilët kanë dhënë vendimin nr. 29, datë 09.02.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër në lidhje me këtë çështje”. Ndërkohë, në shkresën përcjellëse të kësaj kërkesë, zëvendëskryetari shprehet se: “... sqarojmë faktin se këtë çështje mund ta gjykojë gjyqtari relator {...}, anëtar i trupit gjykues {...} dhe gjyqtarja tjetër {...}, por duke qenë se gjyqtare {...} vazhdon të jetë me raport mjekësor deri më datë 07.11.2019, ju drejtohem me këtë kërkesë për shkak të natyrës së ngutshme të shqyrtimit të kësaj dosje”.

Nisur nga sa parashtrohet në kërkesat e zëvendëskryetarit (kryetarit në detyrë) të Gjykatës së Apelit Shkodër lidhur me nevojën e asaj gjykate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se në këto raste nuk identifikohet nevojë në Gjykatën e Apelit Shkodër për gjykimin e atyre dy çështjeve penale konkrete, për sa kohë nuk rezulton dhe as referohet për mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër për gjykimin e atyre çështjeve gjyqësore të veçanta, sikurse përcaktohet në paragrafin III, pika 2, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një

çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Konkretisht, për të dy çështjet për të cilat është kërkuar caktimi i 2 ose 1 gjyqtari nga një gjykatë tjetër, e ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, rezulton se në Gjykatën e Apelit Shkodër janë tre gjyqtarë që nuk kanë pengesë ligjore për shqyrtimin e tyre. Fakti i referuar se gjyqtaret {...} dhe {...} aktualisht janë në kushtet e paaftësisë së përkohshme për punë, nuk klasifikohet si shkak padisponueshmërie ligjore, për sa kohë ato sipas ligjit janë gjyqtare në këto çështje (përderisa nuk kanë pengesë ligjore) dhe nuk ka, sipas ligjit (neneve 17 dhe 21 të Kodit të Procedurës Penale), ndonjë akt të organit gjyqësor të ngarkuar nga ligji që të jetë shprehur për papajtueshmërinë me funksionin e gjyqtarit për gjykimin nga ato të çështjes nr.1 apo të gjyqtarës {...} të çështjes nr.2.

Për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Refuzimin e kërkesave të kryetarit në detyrë (zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër për caktim gjyqtari në dy çështje gjyqësore të veçanta, në kushtet e mosevidentimit të nevojës në kuptim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska për relatimin e situatës.

Atëherë, nëse s’kemi ndonjë diskutim, propozoj që të kalojmë projekt-aktin e propozuar nga Komisioni në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Refuzimin e kërkesës së kryetarit në detyrë (zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e 2 gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë (çështja penale nr.288, datë 04.09.2019 me palë kërkuese: {...}; me objekt: pushim gjykimi), në kushtet e mosevidentimit të “nevojës” në kuptim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Refuzimin e kërkesës së kryetarit në detyrë (zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e 1 gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë (çështja penale nr.285, datë 30.08.2019 me palë kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; të pandehur: {...}, {...}; me objekt: pushim gjykimi), në kushtet e mosevidentimit të “nevojës” në kuptim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**